

## **Irena Nikaj: Platforma dhe vizioni**

Mbi përvojën dhe arritjet e deritanishme shkencore, profesionale dhe institucionale, platforma e punës që paraqes për drejtimin e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë(FEF) ka tre shtylla bazë që synojnë të përmirësojnë dhe çojnë më përpara Fakultetin dhe rezultatet e tij në mësimdhënie, kërkim dhe shërbime që ofron dhe do të ofrojë në të ardhmen. Misioni i FEF, si dhe i UNIKO, është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet nëpërmjet të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve.

Këtë mision FEF, në kuadër të kësaj platforme, do ta realizojë përmes:

Respektimit dhe zbatimit të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve nënligjore, sidomos përsa i përket decentralizimit dhe rritjes së rolit të Departamenteve, të cilët do të inkurajohen dhe mbështeten ta realizojnë më mirë rolin e tyre si njësi bazë në kuadër të njësisë kryesore.

Mbështetja e departamenteve është e lidhur me sigurimin e vazhdimësisë të programeve ekzistuese, hapjen e programeve të reja, bashkëpunimin në fushat e përbashkëta midis tyre brenda FEF, edhe midis Fakulteteve në kuadër të Uniko.

Rritja e cilësisë së pjesëmarrjeve dhe veprimtarive, trajnimeve, konferencave shkencore brenda dhe jashtë vendit do të jetë më mirë e organizuar dhe e mbështetur nga ana financiare. Departamentet, veç apo në bashkëpunim me njëri tjetrin do të inkurajohen të ofrojnë shërbime mbi bazën e specifikave dhe mundësive që kanë, apo që do të krijohen nga bashkëpunimi midis tyre.

Vendimmarrja kolegjiale, që nis nga Departamentet, Dekanati, Asambleja e FEF do të jenë mekanizma të gjallë dhe eficientë për sigurimin e cilësisë, lirisë akademike dhe përparimin e njësisë kryesore.

Rritjes së cilësisë akademike të personelit mësimdhënës, i cili do të mbështetet në përparimin profesional individual dhe në grup, jo vetëm për rritjen e kompetencave akademike në transmetimin e dijes, por edhe për zhvillimin e kërkimit shkencor, sidomos inkurajimi i grupeve të kërkimit të funksionojnë më mirë institucionalisht dhe aplikimi më i organizuar dhe cilësor në projekte në kuadër të programeve IPA, Horizont 2020, Erasmus, etj.

FEF do të rritë dhe përmirësojë gamën e shërbimeve që ofron, por do të inkurajojë që këto shërbime të plotësojnë më mirë kërkesat e komuniteteve në rajon dhe marrë pjesë si ekspert, si pjesëtar apo partner në çdo fushë ku ekspertiza e profesionistëve apo FEF si njësi është e nevojshme dhe rrit cilësinë e realizimit të projekteve, shërbimeve apo kërkimit shkencor.

Studentët janë pjesë e pandashme e gjithë veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare të FEF, ashtu si edhe UNIKO. Ata kanë qenë dhe do të vazhdojnë të jenë faktor i rëndësishëm që vlerëson funksionimin ligjor dhe demokratik të FEF, të organeve dhe strukturave që garantojnë dhe zbatojnë politikat e sigurimit të cilësisë.

Në kuadër të sigurimit të cilësisë, si pjesë edhe e strukturave të mësipërme, studentët japin kontributin e tyre nëpërmjet: pjesëmarrjes në veprimtaritë mësimore, kërkimore dhe shkenore, ashtu si edhe në vlerësimin periodik të stafit, programave të studimit dhe shërbimeve nëpërmjet pyetësorëve, komunikimit sistematik me të gjitha strukturat brenda FEF; sugjerimeve në kuadër të hartimit, miratimit rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre. Ne synojmë t'i zgjerojmë format e aftësimit praktik, profesional dhe mbështetjes më të mirë financiare të studentëve duke i bërë ata pjesë të administrimit të hapësirave, punëve dhe shërbimeve që ofron në FEF.

Që të bëhet i mundur zbatimi i kësaj platforme, ka nevojë për mbështetjen tuaj, të nderuar pjesëtarë të stafit akademik dhe studentë të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

Ju faleminderit!